

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË
SË ENTIT RREGULLATOR
TË ENERGJISË (ERE) PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

- Duke vlerësuar faktin që gjendja financiare në sistemin energjetik u karakterizua nga një performancë në rritje, veçanërisht në uljen e nivelit të humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së furnizimit me energji elektrike;

- Duke konsideruar si një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë mbrojtjen e konsumatorëve;

- Duke vlerësuar se përgjegjësia e ERE-s në zhvillimin e suksesshëm të tregjeve të gazit dhe energjisë elektrike është e madhe, si i vetmi ent që monitoron dhe vendos për zhvillimin e drejtë, të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të tregut;

- Duke konsideruar që një liberalizim i mëtejshëm i tregut të energjisë elektrike garanton një siguri më të lartë furnizimi dhe një zhvillim më të mirë të tregut të energjisë elektrike;

Për vitin 2016:

- Vlerëson bashkëpunimin e ERE-s me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në hartimin e projektligjit “Për performancën e energjisë së ndërtesave” (miratuar në nëntor 2016) dhe në hartimin e projektligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (miratuar në shkurt 2017).

- Vlerëson investimet e bëra nga OST dhe OSHEE në të gjithë vendin, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin cilësor të furnizimit me energji elektrike, në mënyrë të veçantë në zonat turistike të vendit.

- Vlerëson uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të cilat për vitin 2016 u ulën në masën 28,04 për qind kundrejt 31,34 për qind të një viti më parë, duke ruajtur trendin pozitiv rënës të këtij treguesi.

- Vlerëson certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, në kuadër të vendimmarrjeve të ERE-s, ky certifikim shënon një proces me mjaft rëndësi në kuadrin rregullator, por mbi të gjitha në implementimin e kërkesave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Vlerëson investimet e rëndësishme të bëra në rrjetin transmetues, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen edhe më tej të sigurisë së operimit të sistemit, në mënyrë të veçantë vënien në punë e sistemit të kontroll-monitorimit SCADA/EMS, OST siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit.

- Vlerëson vendimet e përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG të tre enteve rregullatore të Shqipërisë, Greqisë dhe Italisë.

- Vlerëson punën e bërë për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë, për të bërë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike në vend dhe e integron atë në tregun rajonal.

- Vlerëson punën e bërë për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë.

- Vlerëson bashkëpunimin me Komunitetin e Energjisë, lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

- Vlerëson bashkëpunimin dhe konsultimin me Autoritetin e Konkurrencës lidhur me aktet e miratuara nga ERE.

- Vlerëson investimin e bërë dhe vënien në punë të centralit Fotovoltaik të UKKO sh.a., me kapacitet rreth 1 MW, si dhe inkurajon nxitjen e investimeve të tjera të ngjashme për prodhimin e energjisë nga dielli, era, biomasa etj., të cilat bëjnë të mundur diversifikimin e burimeve të energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend.

Rekomandon për vitin 2017:

- Në miratimin e tarifave të reja t'i kushtojë një vëmendje të veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa dhe çmime sa më të drejta e të përballueshme dhe, nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanisë.

- Të vijojë punën për nxitjen e krijimit të një tregu të brendshëm dhe hapjen efektive të tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në veçanti, në dritën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke siguruar shërbime të drejta, të sigurt dhe të argumentuara për klientët dhe përdoruesit e sistemit energjetik në vend, si dhe të mbështesë investime strategjike dhe teknologjike, të cilat rrisin konkurrencën dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve në tregun e energjisë elektrike.

- Në kuadër edhe të ligjit të ri "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të bashkëpunojë me të gjithë aktorët, si dhe të luajë një rol proaktiv për krijimin e kushteve të nevojshme dhe nxitjen e investimeve për prodhimin e energjisë, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga era, dielli, biomasa etj., duke bërë kështu të mundur rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend, si dhe uljen e shkallës së lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në miratimin e planit të investimeve të OST-së dhe OSHEE-së, t'i kushtojë një vëmendje të veçantë rritjes së investimeve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.

- Të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, si dhe me institucionet e tjera, në mënyrë që të bëhet një vlerësim i hollësishëm i projekteve të reja të mundshme për ndërtimin e hidrocentraleve, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë impaktit në zona që përbëjnë interes të veçantë lidhur me natyrën.

- Të vijojë punën për hartimi dhe përmirësimin e një sërë aktesh nënligjore të sektorit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat, tashmë, në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësura, por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.

- Të rrisë përpjekjet e tij në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, përmes publikimeve në faqen online të institucionit, si dhe mjeteve të tjera të komunikimit.

- Të kërkojë nga kompania "OSHEE" sh.a. anulimin e faturave të konsumatorëve nën emërtimin "dëm ekonomik" dhe "energji e pamatur" të periudhës 2008 - 2011, në zbatim të vendimit përkatës të ERE-s.

- Me gjithë uljen e ndjeshme të numrit të ankesave të konsumatorëve, krahasuar me një vit më parë, të vijojë trajtimin me seriozitet të tyre, duke kërkuar njëkohësisht një përgjegjshmëri më të lartë nga OSHEE-ja.

- Të vijojë monitorimin e ecurisë së treguesit të arkëtimeve të OSHEE-së, tregues i cili për vitin 2016 shënoi një rënie të lehtë krahasuar me një vit më parë, duke e konsideruar si një tregues shumë të rëndësishëm dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shlyerjen e pagesave ndaj palëve të treta.

- Të vijojë monitorimin e ecurisë së treguesit të humbjeve të OSHEE-së, për të bërë të mundur ruajtjen dhe përmirësimin e mëtejshëm të trendit pozitiv rënës të këtij treguesi, i cili gjatë vitit 2016 pati një ulje të mëtejshme duke arritur në 28,04 për qind krahasuar me 31,34 për qind të një viti më parë.

- Të vijojë përpjekjet për shtimin e kapaciteteve në strukturën e saj, si dhe forcimin e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të stafit të entit, në mënyrë që ERE të zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përballur me sfidat e sektorit.

- Të marrë masat për heqjen e barrierave që pengojnë futjen e pjesëmarrësve të rinj në treg dhe të sigurojë një përfitim të klientëve prej funksionimit të efektshëm të tregut kombëtar.

- Të vazhdojë bashkëpunimin me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë si në kuadër të projektit TAP, ashtu edhe për të përfituar nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes.

- Me miratimin e ligjit "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" (miratuar në shkurt 2017) të fillojë punën për hartimin e akteve nënligjore, si dhe rregulloreve të nevojshme në kuadër të tij.

- Me miratimin e ligjit "Për gazin natyror" dhe në kushtet kur Shqipëria është një ndër vendet e para në

rajon të implementimit të Paketës së Tretë të Energjisë kërkohet një angazhim më i madh i ERE-s, si dhe një bashkëpunim i ngushtë me të gjitha institucionet e tjera që kanë lidhje me këtë problem.

- Të marrë masat e nevojshme për plotësimin e kuadrit të legjislacionit sekondar, në përputhje me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së, të domosdoshëm për certifikimin e Albagazit, si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror. Ky certifikim i paraprin hapit tjetër të rëndësishëm, i cili është dhënia e licencës së aktivitetit të operatorit të transmetimit dhe shpërndarjes Albagazit.

- Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore të nevojshme, në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Miratuar në datën 4.5.2017

KRYETARI
Ilir Meta